VENDIM
Nr.537, datë 1.5.2008

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI NGA MINISTRIA E FINANCAVE TE MINISTRIA E BRENDSHME, TË ISH-NDËRMARRJES SË BAKRIT ARTISTIK, KAVAJË, DHE PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT NR.513, DATË 15.8.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË FINANCAVE, PËR AGJENCINË E TRAJTIMIT TË KREDIVE", E PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.250, DATË 24.4.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, 10, 12 e 15 shkronja "c" të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të ish-ndërmarrjes së bakrit artistik, Kavajë, nga Ministria e Financave, Agjencia e Trajtimit të Kredive, Ministrisë së Brendshme, për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për komisariatin e policisë, Kavajë, sipas formularit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Prona e paluajtshme "Ish-ndërmarrja e bakrit artistik, Kavajë", për efekt regjistrimi, t'i shtohet, përkohësisht, listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.513, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave, e, pas regjistrimit, të hiqet nga kjo listë dhe t'i shtohet listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.250, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Ministrisë së Brendshme i ndalohet t'ia ndryshojë destinacionin pronës së përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, ta tjetërsojë apo t'ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Trajtimit të Kredive dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha